

NSH “KOSOVAKONTROL”NË PRISHTINE – Fi-606/89

**Emrat e mëparshëm/alternativ dhe numrat e regjistrimit:
NSH Jugoinspekti**

**LISTA PËRFUNDIMTARE E PUNETORËVE TË CILËT I KANE PLOTESUAR KUSHTET PER
MARRJEN E NJË PJESE TË TË HYRAVE, SIPAS NENIT 10 TË RREGULLORES SË UNMIK-ut
2003/13 (ME NDRYSHIME)**

Sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) , 20% të të hyrave nga shitjet prej privatizimit dhe likuidimit të NSH-së së lartpërmendur do t’iu shpërndahet punëtorëve të NSH-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

AKM-ja duke adresuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet ndaj listës së përkohshme të publikuar më parë, lëshon listën përfundimtare të personave të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20 % prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës:

Luzha	Asim	21.23	Sadriu	Rexhep	25.50
Pula	Nexhat	7.38	Smakolli	Servete	13.26
Pula - Karaxha	Lirije	21.23	Zhuja	Izet	26.46

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), punëtori ka të drejtë të marrë një pjesë të 20 % të të hyrave nga shitja nëse ai/ajo ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së së lartpërmendur në kohën e privatizimit ose likuidimit (cilado që ka ndodhë më parë) dhe që ka qenë në listën e pagave të NSH-së të paktën për tri vite. Punëtori i cili nuk e plotëson këtë kriter megjithatë mund të ketë të drejtë nëse diskualifikimi i tij/saj është bërë në bazë diskriminuese.

Secili person i cili mendon se ai/ajo do të duhej të jetë përfshirë në listë, që dëshiron ta kundërshtoj një ose më shumë emra në listë, ata të cilët mendojnë se stazhi i tyre i punës nuk është i saktë ose dëshirojnë të bëjnë ankese lidhur me mënyrën e shpërndarjes së fondeve sipas nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), për secilin nga keto çështje mund të parashtrorë **Ankesë** në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me nenin 64.6 të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 në lidhje me Rregullat e Procedurës së Odës së Veçantë. Ankesa duhet të behet me shkrim dhe duhet të përmbaj (1) emrin (emrat) e individit (individëve) në emër të të cilit është parashtruar Ankesa (parashtruesi (parashtruesit e ankesave); (2) adresën e parashtruesit (parashtruesve) të ankesës dhe (3) arsyet e detajuara faktike dhe ligjore për parashtrimin e Ankesës me dëshmi plotësuese (në rastet kur janë të aplikueshme), kurse kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vertetuara nga organi kompetent. Kur Ankesa është parashtruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të Ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), pala e tretë duhet ta siguroj autorizim me shkrim me të cilin vërtetohet se është i autorizuar për të vepruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të Ankesës.

Ankesat duhet të parashtrohen në Odën e Veçantë në kete adrese:

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës që ka të bëjë me çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Rr. Radovan Zogoviq nr. 5, Qyteza Pejton, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38/248 405 ose 248 406; Fax: +381 (0) 38/248 404 ose 213 280
ose

Shtylla IV e EU-së, Zyra e Beogradit, Tolstojeva 47-49, 11000 Beograd, Serbi.

Tel: +381 (0) 11 367 4006

**TË GJITHA ANKESAT NË LIDHJE ME KËTË NJOFTIM DUHET TË DORËZOHEN DERI MË
DATEN 02 QERSHOR 2008 PARA PËRFUNDIMIT TE ORARIT TË PUNËS SË TË NJEJTËS DITË**

Per informata shtese lidhur me ate si duhet te parashtrohet Ankesa, ju rekomandojmë që ju apo avokati juaj të shikoj nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), Kaptinen e V të Urdhërësës Administrative Nr. 2006/17 ose të kontaktoni Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.